



RAPORT TOPOGRAFIK

**Studimi i gjeometrisë së objekteve të dëmtuar nga
tërmeti i dates 26.11.2019**

PALLATI 27498

Durrës

2021



[Handwritten signature]
[Handwritten initials]

1. Vështrim i përgjithshëm

Tërmeti i datës 26 nëntor 2019 shkaktoi dëme të konsiderueshme materiale dhe humane. Për të vlerësuar saktësisht pasojat e kësaj fatkeqësie mbi objektet e prekura, ato do t'i nënshtrohen një analize të thelluar inxhinierike. Kjo analizë shërben për të vlerësuar dhe marrë masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e objekteve.

Një nga pikat përbërëse të kësaj analize të thelluar është edhe analiza gjeometrike. Kjo analizë realizohet duke kryer vrojtime topografike të saktësisë së lartë në objektet e studiuara. Matjet topografike realizohen me qëllim që të mbulojnë të gjithë objektin për të arritur në një përfundim sa më gjithëpërfshirës mbi të.

Tipologjia e objekteve: Objektet e studiuara përfshijnë si objekte të para viteve 90 ashtu edhe objekte të reja me sistem tra-kolonë. Objektet e para viteve 90 paraqiten më problematikë sepse në të gjitha rastet janë të përbëra nga objekti bazë i ndërtuar me tullë silikat dhe nga shtesa në të gjitha orientimet dhe në të gjitha katet e tij. Një aspekt tjetër problematik i këtyre objekteve është edhe amortizimi për shkak të vjetërsisë së tyre.

Objektet qëllim studimi ndodhen në zona kryesisht urbane. Disa prej tyre karakterizohen nga thyerje të shumta të relievit ndërsa disa të tjerë janë në zona fushore. Dendësia urbane është faktor përcaktues edhe i metodikës së punës siç shpjegohet edhe në pikën më poshtë.

2. Metodika e punës

a. Projektimi

Duke pasur parasysh dendësinë urbane të objekteve, disnivelet midis faqeve të ndryshme të objekteve, format dhe përmasat e godinave që do studiohen si dhe saktësinë e lartë që kërkohet për këto lloj studimesh, grupi i punës ka ndërtuar rreth objekteve një bazament gjeodezik i cili do të bëjë të mundur matjet me instrumentat që do të përdoren.



Pikat e bazës gjeodezike janë zgjedhur të tilla që të kenë shikueshmëri reciproke me njëra-tjetrën. Kjo bën të mundur që instrumenti Total Station të vendoset përafërsisht në mes të distancës së tyre në mënyrë që të arrihet një saktësi sa më e lartë në orientimin e tij.

b. Rikonicioni fushor

Gjatë kësaj faze i caktohet çdo pike një identifikues i vetëm. Metoda më e zakonshme është që pikave t'ju caktohet një numër rendor në mënyrë të njëpasnjëshme ose emra të veçantë për çdo pikë. Ne kemi zgjedhur që pikat t'i emërtojmë ST1, ST2, ST3....., ndërsa numri i tyre është i tillë që të arrijmë të orientohemi dhe masim me instrument aq herë sa është e nevojshme për të matur të gjitha pikat kyçe, nga të cilat do të dalin vlerat e verticalitetit të objektit.

c. Instrumentat gjeodezike të përdorur

Për të kryer matjet u përdorën këto instrumenta gjeodezike:



Topcon Imaging Station IS-3 (1'')



A handwritten signature in blue ink is located in the bottom right corner, below the stamp. The signature is stylized and appears to be "Arkonstudio".

| Angle Measurement | |
|-----------------------|-------------------------------|
| Method | Absolute Reading |
| Minimum Reading | 1"/5" (0.1 / 0.5 mgon) |
| Accuracy | 1", 3", 5" (0.3 mgon) |
| Tilt Correction | Dual Axis |
| Compensating Range | ± 1.8 m |
| Distance Measurement | |
| Prism Mode | |
| 1 prism | 3,000 m |
| 3 prism | 4,000 m |
| 9 prism | 5,000 m |
| Accuracy (Fine) | ± (2 mm + 2 ppmxD) m.s.e. |
| Non-Prism Mode | 1.5 m - 250 m |
| NP Accuracy (Fine) | ± (3 mm) m.s.e. |
| Non-Prism Long Mode | 5.0 m - 2,000 m |
| NP Long Mode Accuracy | ± (10 mm + 10 ppmxD) m.s.e. |
| Imaging | |
| Cameras (2) | 1.3 megapixel |
| Image speed | 1 - 10 fps |
| Scanning | Max 20 pts/sec |
| User Interface | |
| OS | Microsoft Windows® CE.NET 4.2 |
| Processor | Intel® PXA255 400 MHz |
| Screen | Full Color Touch-screen |

Specifikime të instrumentit

Për matjet GNSS dhe lidhjen e koordinatave lokale me sistemin WGS84 UTM ZONE 34N, u përdor pajisja GPS CHC i50.



Pajisja GPS CHC i50



[Handwritten signatures]

| GNSS Characteristics ⁽¹⁾ | |
|-------------------------------------|---|
| Channels | 624 |
| GPS | L1, L2, L2C, L5 |
| GLONASS | L1, L2 |
| Galileo | E1, E5a, E5b |
| BeiDou | B1, B2, B3 |
| SBAS | L1 |
| QZSS | L1, L2, L5 |
| GNSS Accuracies ⁽²⁾ | |
| Realtime kinematics (RTK) | Horizontal: 8 mm + 1 ppm RMS Vertical: 15 mm + 1 ppm RMS Initialization time: < 10 s Initialization reliability: > 99.9% |
| Post-processing kinematics (PPK) | Horizontal: 3 mm + 1 ppm RMS Vertical: 5 mm + 1 ppm RMS |
| Post-processing static | Horizontal: 3 mm + 0.5 ppm RMS Vertical: 5 mm + 0.5 ppm RMS |
| Code differential | Horizontal: 0.4 m RMS Vertical: 0.8 m RMS |
| Autonomous | Horizontal: 1.5 m RMS Vertical: 3.0 m RMS |
| Positioning rate | Up to 10 Hz |
| Time to first fix ⁽³⁾ | Cold start: < 45 s Hot start: < 10 s Signal re-acquisition: < 1 s |
| Hardware | |
| Size (L x W x H) | 140 mm x 130 mm x 106 mm (5.5 in x 5.1 in x 4.2 in) |
| Weight | 1.29 kg (2.8 lb) |
| Environment | Operating: -40°C to +65°C (-40°F to +149°F) Storage: -40°C to +75°C (-40°F to +167°F) |
| Humidity | 100% condensation |
| Ingress protection | IP67 waterproof and dustproof, protected from temporary immersion to depth of 1 m |
| Shock | Survive a 2-meter pole drop |
| Tilt sensor | E-Bubble leveling |
| Front panel | 6 status LED |
| Certifications | |
| CE Mark, MIL-STD-810G Vibration | |

| Communications And Data Storage | |
|---|---|
| Network modem | Integrated 4G modem LTE (FDD): B1, B2, B3, B4, B5, B7, B8, B20 DC-HSPA+/HSPA+/HSPA/UMTS: B1, B2, B5, B8 EDGE/GPRS/GSM 850/900/1800/1900 MHz |
| Wi-Fi | 802.11 b/g/n, access point mode |
| Bluetooth ® | v4.1 |
| Ports | 1 x 7-pin LEMO port (external power and RS-232) 1 x Mini-USB (data download, firmware update) 1 x UHF antenna port (TNC female) |
| UHF radio | Internal Rx/Tx: 410 - 470 MHz Transmit Power: 0.5 W to 2 W Protocol: CHC, Transparent, TT450 Link rate: 9600 bps to 19200 bps Range: Typical 3km to 5km RTCM2.x, RTCM3.x, CMR input/output |
| Data formats | HCN, HRC, RINEX 2.11, 3.02 NMEA0183 output NTRIP Client, NTRIP Caster |
| Data storage | 8 GB internal memory |
| Electrical | |
| Power consumption | 4.2 W (depending on user settings) |
| Li-ion battery capacity | 2 x 3400 mAh, 7.4 V |
| Operating time on internal battery ⁽⁴⁾ | UHF receive/transmit (0.5 W): 5 h to 7 h Cellular receive only: up to 10 h Static: up to 12 h |
| External power input | 9 V DC to 36 V DC |

Specifikime të instrumentit



[Handwritten signature]

d. Procesi i matjeve

- Baza gjeodezike

Për shkak të dendësisë së lartë urbane për disa objekte nuk mund të maten të gjitha pikat e bazës me pajisjen GPS. Për këtë arsye, për disa nga godinat që do të studionen, pikat e bazës gjeodezike janë hedhur duke i matur me instrumentin Total Station (me mini prizëm sepse siguron saktësi më të lartë në matjen e pikave) dhe më pas, larg zonës së dendur urbane, atje ku sigurohet sinjali i nevojshëm nga satelitët, hidhen disa stacione të tjera. Këto të fundit maten si me pajisjen GPS ashtu edhe me Total Station për të bërë të mundur lidhjen e rrjeteve të matura me anë të programeve kompjuterike si Autocad Civil 3D. Në këtë mënyrë, në databazën e pikave të Total Station-it do të jenë të gjitha pikat për të vijuar me rilevimin e detajuar të objekteve.

- Rilevimi i detajuar

Fillimisht centrohet instrumenti në një pozicion të tillë që të ketë shikueshmëri me të paktën dy stacione (orientimi është kryer kryesisht me 3 stacione). Më pas, me anë të modalitetit "Resection", janë matur pikat e stacioneve me mini prizëm për të përfunduar procesin e orientimit të instrumentit.

Pas orientimit, vijohet me rilevimin e detajuar të objekteve. Për çdo objekt, në brinjët skajore të tij, matet pika poshtë e brinjës së objektit dhe pika sipër e po kësaj brinje. Këto pika do të shërbejnë për të përcaktuar vertikalishtet e brinjës dhe të gjithë strukturës në tërësi. Gjithashtu maten edhe pjesët e tjera që mund të jenë shtesa, konsola, ballkone etj. për të përfituar konturin e objektit. Rilevimi i objektit plotësohet duke matur edhe rrugët kufitare të tij.



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized cursive letters.

Në figurën më poshtë tregohet rievimi i objektit i përfuar nga matjet në terren me anë të pajisjeve Total Station dhe GPS. Koordinatat janë sipas sistemit UTM WGS84, Zona 34N.




[Handwritten signature]


3. Vertikaliteti i objektit

Nëpërmjet matjeve të kryera me anë të instrumentit të përdorur, arrijmë të përcaktojmë vlerën e vertikalitetit në brinjët ku janë matur pikat poshtë dhe lart të së njëjtës brinjë.


Shënim: Për shkak të shtesave dhe ndërhyrjeve ndër vite në disa objekte ose për shkak të formës arkitektonike të objektit, nuk është e mundur që të maten në të gjitha brinjët pikat skajore poshtë (pranë kuotës 0.00m të objektit) dhe lart (pranë soletës të katit të fundit). Për këtë arsye, në disa brinjë janë matur pika atje ku brinja ka qënë e mundur të shihet qartë skaji i saj.



Vertikaliteti 1
Diferenca 0.038m




Vertikaliteti 2
Diferenca 0.016m




[Handwritten signature]
[Handwritten initials]

Vertikaliteti 3
Diferenca 0.049m



Vertikaliteti 4
Diferenca 0.034m



[Handwritten signatures]

Two handwritten signatures in blue ink are located below the stamp.

4. Përfundime

Nga vëzhgimi dhe matjet e objekteve, dolëm në përfundimin që faktorët kryesore që ndikojnë në vertikalishtet e objektit janë:

- Shtesat dhe ndërhyrjet ndër vite në objektet që studiohen
- Amortizimi i objekteve si pasojë e kohës që ka kaluar që nga ndërtimi i tij (sidomos në objektet para viteve 1990)
- Dëmtimet nga tërmetet
- Difektet në vertikalishtet që në ndërtimin e tij (shmangie në vertikalishtet, diferenca në shtresën e jashtme të materialit të fasadës etj.)

Nga matjet gjeodezike në terren shihet që objekti ka shmangie në vertikalishtet që variojnë nga 1.6cm deri në 4.9cm.

Gjithsesi, duke mos pasur vlera të mëparshme për të bërë krahasimet, nuk mund të dalim në përfundime se sa ka qënë shmangia reale në vertikalishtet si pasojë e tërmetit.

Punoi

Inxhinier topograf Gj. Loci
Licensa T.1236

Inxhinier gjeodet O. Muçaj





Handwritten signature



Gjergji
Loci

Digitally signed by
Gjergji Loci
Date: 2021.06.30
11:50:25 +02'00'



[Handwritten signature]